



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 24.5.2024

Nr: 52

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË
SUBJEKTIT VETËDEKLARUES Z. LEONARD VYRTYT HIDE, KRYETAR BASHKIE
NË BASHKINË LIBOHOVË, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR “PARTIA
SOCIALISTE E SHQIPËRISË ”**

Sot në datën 24.5.2024, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Leonard Vyrtyt Hide, kryetar në Bashkinë Libohovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Baza ligjore: Nenet 5, 11 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut II, III, V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Në zbatim të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për

Data: 24.5.2024 Nr:52
Ora:12:00



Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Leonard Vyrtyt Hide, kryetar në Bashkinë Libohovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”

funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kryetari i Bashkisë”.

z. Leonard Vyrtyt Hide, është propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, si kandidat për kryetar në Bashkinë Libohovë, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Për këtë kandidat në datën 31.03.2023, pranë KQZ është depozituar formulari e vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. unik GJR-PS-13983. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Leonard Vyrtyt Hide, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, KQZ ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB). Në përgjigje të kësaj kërkesë të KQZ, DPB informon se kandidati në fjalë nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

(1) Me vendimin nr. 558, datë 23.05.2023 të KSHZ-së, z. Leonard Vyrtyt Hide, i është dhënë mandati i kryetarit të Bashkisë Libohovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

(2) Subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë” me anë të shkresës nr. 1297, datë 16.05.2024 informon KQZ-në se, z. Leonard Vyrtyt Hide ka qënë në hetim në vitin 2021 nga Prokuroria Gjyrokastër, për çështjen e kanabisit të Qarkut Gjyrokastër, në kohën kur ai ushtronte detyrën e shefit të Seksionit të Krimeve në Komisaratin e Gjyrokastër. Rezulton se këtë të dhënë, ai nuk e ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit të depozituar në KQZ.

Gjithashtu me anë të kësaj shkrese, subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë” informon KQZ-në se për z. Leonard Vyrtyt Hide, SPAK ka përfunduar hetimet dhe e ka dërguar çështjen për gjykim pranë Gjykatës së Posaçme.. *“pasi dyshohet se në kohën që ka pasur detyrën e shefit të Seksionit të Krimeve në Komisaratin e Gjyrokastër, ka lejuar përkundrejt përfitimit kultivimin e bimëve narkotike”.*

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

V E N D O S:

1. Kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues z. Leonard Vyrtyt Hide, Kryetar në Bashkinë Libohovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, dhe dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI